FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION

FGJK - KGF

RAPORTI NARRATIV

PËR VITIN 2025

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE ME SPECIFIKIME

Federata e Gjimnastikës së Kosovës

01 Janar - 31 Dhjetor 2025

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

PËRMBAJTJA

1.1 HYRJE 4
1.2 PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT VJETOR TË FGJK-së 4
1.3 ANALIZË PËRMBLEDHËSE E ZBATIMIT TË PROGRAMEVE DHE PROCEDURAVE 4
1.4 FINANCIMET – MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MKRS - FGJK 39
1.5 FUSHAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË FINANCIMIT 40
1.6 SHTRIRJA TERRITORIALE E PROJEKTEVE TË MBËSHTETURA 40
1.7 PËRFITUESIT E DREJTPËRDREJT 41
1.8 INFORMACION LIDHUR ME REZULTATET E PROJEKTEVE 41
1.9 REKOMANDIMET PËRKITAZI ME MBËSHTETJEN FINANCIARE GJATË PERIUDHËS SË ARDHSHME 42

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.1 HYRJE

Federata e Gjimnastikës e Kosovës (FGJK) gjatë vitit 2025 ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh të parapara në kalendarin vjetor të punës. Përkundër sfidave financiare dhe vonesave në ekzekutimin e TV-ve, shumica dërrmuese e aktiviteteve të planifikuara janë realizuar me sukses. Gjithashtu vlen të ceket se FGJK gjatë vitit 2025 ka arritur t'i përmbyllë 90% të aktiviteteve me 3 TM.

1.2 PËRMBLEDHJE E ANGAZHIMIT VJETOR TË FGJK-së

Gjatë vitit 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka realizuar aktivitete në disa fusha kryesore të veprimtarisë së saj, duke filluar me funksionalizimin e plotë të organeve drejtuese pas mbajtjes së Kuvendit Zgjedhor. Në vazhdimësi, Federata ka organizuar gara vendore sipas sistemit të miratuar të garave, ka zhvilluar kampe stërvitore jashtë vendit me qëllim ngritjen e nivelit përgatitor të sportistëve, si dhe ka siguruar pjesëmarrje në gara ndërkombëtare. Po ashtu, përfaqësuesit e Federatës kanë marrë pjesë në kongrese evropiane, takim me Federatën Ballkanike, janë organizuar trajnime për gjyqtarë dhe trajnerë, krahas aktiviteteve të tjera që kanë kontribuar në zhvillimin dhe avancimin e gjimnastikës në Republikën e Kosovës.

1.3 ANALIZË PËRMBLEDHËSE E ZBATIMIT TË PROGRAMEVE DHE PROCEDURAVE

FGJK gjatë vitit 2025, ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje të Bordit Ekzekutiv ku të bashkangjitur gjeni 4 prej procesverbalëve në të cilët janë marrë vendime, gjithashtu janë mbajtur edhe mbledhje tjera të komisioneve të FGJK-së, ndërsa Kuvendi i Punës së FGJK-së planifikohet të mbahet në mes të muajit mars 2026. Në këto mbledhje të FGJK-së janë diskutuar shumë pika, dhe vendime si dhe shumë propozime, si për sigurimin e veglave, për infrastrukturën, trajnime të ndryshme, gara, si dhe pagesë të meditjeve për anëtarët e FGJK-së, varësisht nga aktiviteti i tyre si në komisione, mbledhje, organizim të garave, pagesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Sekretarit Teknik.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kuvendi Zgjedhor

Me 19 Janar 2025 FGJK mbajti Kuvendin e Punës dhe Zgjedhor, ku u zgjodhën organet drejtuese të Federatës për mandatin e ri.

Pozita e Kryetarit të FGJK-së iu besua Z. Shkumbin Maqastena, Nënkryetar i parë u zgjedh Besim Halilaj dhe nënkryetare e dytë Sherife Aliqkaj Qerimi ndërsa Sekretar i përgjithshëm i FGJK-së edhe për një mandat u zgjedh Amir Tahiraga dhe Sekretar Teknik Arlind Shaqiri, që të gjithë me vota absolute, pa asnjë votë kundër apo abstenime. Po ashtu Kuvendi zgjedhi edhe Kryesinë (Bordin) e ri dhe organet tjera.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrje në Asamblenë e Përgjithshme dhe Zgjedhore të Komitetit Olimpik të Kosovës

Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme dhe Zgjedhore të Komiteti Olimpik i Kosovës, e mbajtur më 7 shkurt 2025 në Prishtinë.

FGJK u përfaqësua nga Kryetari Shkumbin Maqastena dhe Nënkryetarët Shera Aliçkaj Qerimi dhe Besim Halilaj.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrje në ceremoninë "Laureatët 2024" të Komitetit Olimpik të Kosovës

Federata e Gjimnastikës e Kosovës, e përfaqësuar nga selektorja Doruntinë Ibrahimi, sportistet Vilëza Zeqiri dhe Sara Pllana si dhe Kryetari i FGJK-së Shkumbin Maqastena, mori pjesë në ceremoninë "Laureatët 2024", të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Gara Kontrolluese për Përzgjedhjen e Ekipit për "Salamunov Memorial"

Më 8 mars 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi një garë kontrolluese për gjimnastet e lindura në vitin 2015 dhe më të reja.

Kjo garë kishte për qëllim vlerësimin teknik dhe përzgjedhjen e ekipit përfaqësues që do të përfaqësojë Republikën e Kosovës në garën ndërkombëtare "Salamunov Memorial" në Slloveni.



Gjimnastrada e Kosovës 2025

Me 15 Mars 2025, FGJK organizoi "Gjimnastrada e Kosovës 2025", një ngjarje gjithëpërfshirëse me pjesëmarrjen e 186 gjimnastëve nga klube të ndryshme të vendit.

Ky aktivitet kishte karakter promovues dhe masivizues, duke përfshirë kategori të ndryshme dhe duke rritur interesimin për sportin e gjimnastikës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Palestra në Fushë Kosovë

Gjatë vitit 2025, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, njoftoi shpalljen e procedurave të prokurimit për ndërtimin e palestrës së gjimnastikës në Fushë Kosovë, për të cilën janë ndarë 2 milionë euro. Kjo palestër, e projektuar sipas standardeve të Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (FIG), pritet të krijojë kushte moderne për zhvillimin e sportit të gjimnastikës në Republikën e Kosovës dhe të kontribuojë në ngritjen e nivelit të përgatitjes sportive të gjeneratave të reja.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kampi Stërvitor Ndërkombëtar në Osijek, Kroaci

Nga data 7 deri më 13 prill 2025, gjimnastet e Kosovës morën pjesë në kampin stërvitor të organizuar në qendrën sportive SokolCentar në Osijek, Kroaci. Ky kamp ishte pjesë e programit përgatitor për garat e ardhshme ndërkombëtare. Stërvitjet u zhvilluan dy herë në ditë, në kushte moderne dhe profesionale.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Vizita Zyrtare e Presidentit të Federatës Ballkanike të Gjimnastikës

Gjatë vitit 2025, Presidenti i Federatës Ballkanike të Gjimnastikës dhe i Federatës Turke të Gjimnastikës, Suat Çelen, realizoi një vizitë zyrtare në Kosovë, ku u prit nga drejtuesit e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës dhe nga përfaqësuesit e Komiteti Olimpik të Kosovës.

Në Federatë, ai u prit nga Kryetari Shkumbin Maqastena, nënkryetarët Besim Halilaj dhe Sherife Aliçkaj Qerimi, si dhe Sekretari i Përgjithshëm Amir Tahiraga. Ndërsa në Komitetin Olimpik të Kosovës u zhvillua takim me Presidentin Ismet Krasniqi dhe Sekretarin e Përgjithshëm Besim Aliti.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Stërvitja Seleksionuese për Garën Ndërkombëtare "ConfSport Italia"

Më datat 30 prill dhe 1 maj 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi stërvitjen seleksionuese për përzgjedhjen e ekipit të dytë përfaqësues që do të marrë pjesë në garën ndërkombëtare "ConfSport Italia".
Në këtë stërvitje të përbashkët morën pjesë 23 gjimnaste nga klube të ndryshme të Kosovës. Në bazë të rezultateve dhe performancave të paraqitura, seleksionueset Abeliana Bregu dhe Doruntinë Ibrahimi do të bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të ekipit pjesëmarrës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Përfshirja e Gjimnasteve në Programin "Shpresa Olimpike 2025"

Me 06 maj 2025, Komiteti Olimpik i Kosovës ka nënshkruar kontratat me 46 bursistë të rinj në kuadër të programit "Shpresa Olimpike 2025".

Ndër përfitueset e këtij programi ishin edhe katër sportistet e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës: Bora Hoti, Vilëza Zeqiri, Kaltrina Thaqi dhe Valëza Rama.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Vizita Zyrtare e Presidentit të FIG në Prishtinë

Gjatë vitit 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës pati nderin të mirëpresë në Prishtinë Presidentin e Fédération Internationale de Gymnastique, Morinari Watanabe, në një vizitë zyrtare me rëndësi të veçantë për zhvillimin e sportit të gjimnastikës në vend.

Gjatë qëndrimit të tij, Presidenti Watanabe u prit nga udhëheqësit e FGJK-së, përfaqësues të Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komiteti Olimpik i Kosovës, si dhe nga Kryetari i Federatës Shqiptare të Gjimnastikës. Në kuadër të vizitës, ai vizitoi objektet sportive dhe zhvilloi takime pune për projektet që synojnë ngritjen e cilësisë, përmirësimin e infrastrukturës dhe fuqizimin e rolit të Kosovës në arenën ndërkombëtare të gjimnastikës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kursin Bazik për Gjyqtarët e Rinj në Gjimnastikë

Federata e Gjimnastikës e Kosovës (FGJK) ka realizuar Kursin Bazik për Gjyqtarët e Rinj në Gjimnastikë Artistike, i mbajtur më 08 dhe 20 maj 2025 në ambientet e zyrës së FGJK-së në Prishtinë.
Kursi, i organizuar në kuadër të planit vjetor të federatës, kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përgatitjen e një gjenerate të re gjyqtarësh



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Gara e Nivelit C në Gjimnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj

Më 24 maj 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi Garën e Nivelit C në gjimnastikën artistike për femra dhe meshkuj. Në këtë aktivitet morën pjesë 180 garues nga klube të ndryshme të vendit.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Garën Ndërkombëtare "ConfSport Italia" - Napoli

Më 31 maj 2025, gjimnastet e Kosovës morën pjesë në garat ndërkombëtare të gjimnastikës artistike të organizuara nga "ConfSport Italia" në Napoli, Itali, ku arritën rezultate të mira për Federatën dhe vendin tonë. Në këtë aktivitet ndërkombëtar, Jora Gërvalla zuri vendin e dytë në kapërcime në kategorinë Elite, ndërsa Rene Xhambazi fitoi vendin e tretë në 4-garësh në kategorinë Seria A.
Ekipi përbëhej gjithashtu nga Tiara Dragusha, Erlisa Bogaçku, Sumeja Hoxha, Elma Gashi, Troja Haradinaj, Olta Breznica, Vanesa Haziri dhe Flatra Peja, të cilat paraqitën performanca cilësore dhe konkurruese. Gjimnastet u udhëhoqën nga trajnerët Sherife Aliçkaj Qerimi, Ard Kryeziu dhe Arbenita Oraca.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Kampionatin e Gjimnastikës Artistike të Maqedonisë

Më 31 maj 2025, ekipi i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës mori pjesë në Kampionatin e Gjimnastikës Artistike të Maqedonisë, ku gjimnastet tona paraqitën performanca cilësore dhe me nivel të lartë teknik. Nën udhëheqjen e trajnerëve Besnik Latifi, Lisa Zeqiri dhe Qendresa Halili, gjimnastet Duana Parduzi, Adea Shala, Lisa Ahmeti, Hana Rapucaj, Fiona Avdiu, Jara Gumnishta dhe Lorena Idrizi përfaqësuan vendin me dinjitet dhe profesionalizëm.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Gara "Šalamunov Memorial 2025" në Maribor, Slloveni

Ekipi i Kosovës mori pjesë në garën ndërkombëtare të gjimnastikës artistike për femra "Šalamunov Memorial 2025", të mbajtur në Maribor, Slloveni. Në ditën e parë të kualifikimeve, sportistja Fernaze Cakaj arriti sukses duke fituar vendin e tretë në 4-garësh (all around) në kategorinë Youth, me 43.366 pikë, në një konkurrencë të fortë ndërkombëtare.



Finalja në "Šalamunov Memorial 2025" në Maribor, Slloveni

Më 8 qershor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës u përfaqësua në finalet e garës ndërkombëtare "Šalamunov Memorial", e zhvilluar në Maribor të Sllovenisë, me dy sportiste finaliste në një garë zyrtare të Federatës ndërkombëtare të gjimnastikës, Sara Pllana dhe Kaltrina Thaqi.
Në finalet e zhvilluara, Sara Pllana arriti sukses duke fituar medaljen e artë në parter me 11.900 pikë dhe medaljen e bronztë në kapërcime me mesataren 11.725 pikë.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Takimin Zyrtar të Federatës Ballkanike të Gjimnastikës

Nga data 13 deri më 15 qershor 2025, Kryetari Shkumbin Maqastena dhe Sekretari Teknik Arlind Shaqiri përfaqësuan Federata e Gjimnastikës e Kosovës në një takim zyrtar të organizuar nga Federata Ballkanike e Gjimnastikës në Turqi.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Gara e Nivelit B në Gjimnastikën Artistike

Më 28 qershor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi Garën e Nivelit B në Gjimnastikën Artistike, me pjesëmarrjen e rreth 95 gjimnasteve nga klubet e Kosovës, si dhe me praninë e mysafirëve nga Shqipëria.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Kursin për Administratorët e Sportit

Gjatë vitit 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës ishte pjesëmarrëse në Kursin për Administratorët e Sportit, të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në "European Gymnastics WAG Training Camp 2025" në Kuortane, Finlandë

Nga data 7 deri më 17 korrik 2025, ekipi i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës mori pjesë në "European Gymnastics WAG Training Camp 2025", të mbajtur në Kuortane, nën organizimin e European Gymnastics. Arlind Shaqiri, Abeliana Bregu, Sherife Qerimi, Fernaze Cakaj, Djellona Azemi dhe Hira Haziri perfaqësuan FGJK-në në këtë kamp.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në EYOF 2025

Nga data 20 deri më 26 korrik 2025, gjimnastet e Kosovës morën pjesë në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj – European Youth Olympic Festival (EYOF 2025), duke përfaqësuar vendin në disiplinat parter, kapërcime, paralele dhe tra ekuilibri. Në një konkurrencë me 98 garuese nga shtete të ndryshme të Evropës, sportistet Sara Pllana, Bora Hoti dhe Rea Berisha patën paraqitje të mirë dhe konkurruese. Veçohet disiplina e parterit, ku Sara Pllana u rendit e 30-ta me 12.050 pikë, Bora Hoti e 60-ta me 11.200 pikë dhe Rea Berisha e 82-ta me 10.350 pikë.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Përfundimi i Kursit Ndërkombëtar për Gjyqtare të Gjimnastikës Ritmike

Gjatë vitit 2025, Fiona Konxheli ka përfunduar me sukses Kursin Ndërkombëtar për Gjyqtare të Gjimnastikës Ritmike - "International Judges Course (XVII Cycle)", të organizuar nga Fédération Internationale de Gymnastique.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Kampionatin e 8-të Mesdhetar në Gjimnastikën Artistike 2025

Nga data 3 deri më 8 tetor 2025, ekipi i Kosovës mori pjesë për herë të parë në Kampionatin e 8-të Mesdhetar në Gjimnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj, i zhvilluar në Stamboll, Turqi.
Në këtë aktivitet ndërkombëtar, Kosovën e përfaqësuan gjimnastet Sara Pllana, Bora Hoti dhe Rea Berisha, nën udhëheqjen e trajnereve dhe selektoreve Abeliana Bregu dhe Doruntinë Ibrahimi. Pjesë e delegacionit ishte edhe doktoresha Blerina Mema, e cila ofroi mbështetje mjekësore për ekipin.



Finalja e Kampionatit të 8-të Mesdhetar 2025

Në kuadër të pjesëmarrjes së parë të Kosovës në Kampionatin Mesdhetar të Gjimnastikës Artistike 2025, të mbajtur në Stamboll, gjimnastet tona arritën rezultate të rëndësishme në konkurrencë me shtete me traditë të gjatë në këtë sport. Në finalen e mbajtur me 07 tetor 2025, Sara Pllana u rendit e pesta në finale në tri disiplina: parter, kërcime dhe tra, duke konfirmuar nivel të lartë konkurrues në arenën ndërkombëtare. Bora Hoti arriti të pozicionohet në mesin e tetë më të mirave në disiplinën e parterit.
Në garën ekipore, Kosova u rendit e katërta.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pranimi dhe Shpërndarja e Donacionit me Pajisje Gjimnastikore

Më 16 tetor 2025, në Prishtinë, Federata e Gjimnastikës e Kosovës, në bashkëpunim me Komiteti Olimpik i Kosovës, pranoi një donacion të rëndësishëm me pajisje gjimnastikore nga shteti i Holandës, përkatësisht nga organizata Sports for Children. Pajisjet e pranuara u shpërndanë në klubet anëtare të Federatës.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kaltrina Thaqi: Përfituese e Bursës Olimpike "LA 28"

Kaltrina Thaqi është përzgjedhur përfituese e programit "Bursa Olimpike LA 28", e mbështetur nga Solidariteti Olimpik i International Olympic Committee dhe Komiteti Olimpik i Kosovës.

Për herë të parë, gjimnastika kosovare bëhet pjesë e këtij programi të rëndësishëm.



Pjesëmarrja në Kampionatin e 4-t Ballkanik - Zadar 2025

Nga data 2 deri më 6 nëntor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë në Kampionatin e 4-t Ballkanik të Gjimnastikës Artistike, i mbajtur në Zadar, Kroaci. Delegacioni i Kosovës përbëhej nga 9 gjimnaste: Bora Hoti, Rea Berisha, Sara Pllana, Fernaze Cakaj, Djellona Azemi, Jora Gërvalla, Hira Haziri, Borë Krasniqi dhe Hira Elshani, të cilat përfaqësuan vendin në këtë garë të rëndësishme rajonale. Ekipi u udhëhoq nga Kryetari i Federatës Shkumbin Maqastena, shefi i delegacionit Besnik Latifi, trajnerët Doruntinë Ibrahimi, Abeliana Bregu dhe Arlind Shaqiri, si dhe doktoresha e ekipit Blerina Mema.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Finalja e Kampionatit Ballkanik - Zadar 2025

Më 6 nëntor 2025, në kuadër të Kampionatit të 4-t Ballkanik të Gjimnastikës Artistike të mbajtur në Zadar, Kroaci, gjimnastja Sara Pllana fitoi medaljen e bronztë në veglën e traut (balance beam), duke shënuar një moment historik për gjimnastikën kosovare.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Turneun Ndërkombëtar "Horizon Cup" - Selanik

Nga data 7 deri më 9 nëntor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë në turneun ndërkombëtar "Horizon Cup", me pjesëmarrje të gjimnasteve nga vende të ndryshme të Evropës. Kosovën në këtë garë e përfaqësuan gjimnastet në kategorinë Juniore: Elisa Bogaçku, Elena Sefa, Vlera Gërguri dhe Era Avdiu, si dhe në kategorinë Pre-Juniore: Rene Xhambazi, Troja Haradinaj, Tiara Dragusha dhe Elma Gashi.
Ekipi u udhëhoq nga trajnerët Sherife Qerimi, Amir Januzi, Lisa Zeqiri dhe Qendresa Halili.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Organizimi i Seminarit për Trajnerë të Gjimnastikës, dita e parë

Më 15 nëntor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi ditën e parë të seminarit për trajnerë të gjimnastikës, i mbajtur në Hotel Sirius në Prishtinë. Temat e trajtuara përfshinë: "Safeguarding në gjimnastikë dhe roli i trajnerit: etikë dhe komunikim", ligjëruar nga Amir Tahiraga; "Ushqimi, gjumi dhe rikuperimi", ligjëruar nga Prof. Faton Tishukaj; "Planifikimi i ushtrimeve dhe trajnimi optimal për fëmijët në rritje", ligjëruar nga Prof. Besim Halilaj; "Përgatitja fizike për gjimnastikë", ligjëruar nga Shkumbin Maqastena; si dhe "Metodat për mësimin e elementeve gjimnastikore dhe biomekanika", ligjëruar nga Arlind Shaqiri.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Dita e Dytë e Seminarit për Trajnerë - Ndihma e Parë

Më 16 nëntor 2025 u zhvillua dita e dytë e seminarit për trajnerët e gjimnastikës, e cila iu kushtua temës së Ndihmës së Parë, si një kompetencë thelbësore për garantimin e sigurisë në ambientet stërvitore. Trajnimi u udhëhoq nga një ligjërues profesionist i Kryqit të Kuq të Kosovës, ku u prezantuan procedurat kryesore të reagimit në situata emergjente dhe mënyrat e duhura të veprimit në raste lëndimesh apo gjendjesh të papritura. FGJK pajisi çdo klub me çantë profesionale me pajisje esenciale të ndihmës së parë, e dedikuar për përdorim në ambientet ku i mbajnë stërvitjet gjimnastikore.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Pjesëmarrja në Kongresin e 31-të të European Gymnastics - Pragë

Më 28–29 nëntor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë në Kongresin e 31-të të European Gymnastics, i zhvilluar në Pragë, Çeki. Delegacioni i FGJK-së përbëhej nga Kryetari Shkumbin Maqastena, Nënkryetari Besim Halilaj dhe Sekretari i Përgjithshëm Amir Tahiraga.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

Kampionati i Kosovës në Gjimnastikën Artistike 2025

Më 6 dhjetor 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës organizoi Kampionatin e Kosovës në Gjimnastikën Artistike për Femra dhe Meshkuj, me pjesëmarrjen e sportistëve nga klube të ndryshme të vendit. Ky aktivitet përfaqëson garën më të rëndësishme vendore të vitit.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.4 FINANCIMET – MEMORANDUM BASHKËPUNIMI MKRS - FGJK

Federata e Gjimnastikës e Kosovës gjatë vitit 2025 ka funksionuar në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar më 04 mars 2025 me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). MKRS mbetet financuesi kryesor i Federatës së Gjimnastikës e Kosovës, duke siguruar mbështetjen institucionale dhe financiare për realizimin e aktiviteteve të parapara në planin vjetor të punës. Përmes këtij memorandumi është mundësuar organizimi i garave vendore, pjesëmarrja në gara ndërkombëtare, zhvillimi i kampeve stërvitore, organizimi i seminareve për trajnerë dhe gjyqtarë, si dhe funksionimi administrativ i Federatës. Pavarësisht vonesave në ekzekutimin e mjeteve sipas tremujorëve, Federata ka arritur të realizojë pjesën më të madhe të aktiviteteve të planifikuara, duke menaxhuar në mënyrë të kujdesshme buxhetin dhe duke respektuar obligimet ligjore dhe raportuese ndaj MKRS-së. Mbështetja e MKRS-së ka qenë thelbësore për vazhdimësinë e aktiviteteve të FGJK-së dhe për arritjet e shënuara gjatë vitit 2025, përfshirë sukseset ndërkombëtare dhe zgjerimin e bazës së pjesëmarrësve në nivel vendor.



FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.5 FUSHAT E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA TË FINANCIMIT

Gjatë vitit 2025, Federata e Gjimnastikës e Kosovës ka realizuar një numër të madh aktivitetesh në kuadër të planit vjetor të punës, duke përfshirë organizimin e garave vendore, pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare, organizimin e kampeve stërvitore, seminare për trajnerë dhe staf të Federatës, trajnime në ndihmë të parë, pjesëmarrje në programe të ASMC-së, si dhe në kursin për administrim sportiv, ndër të tjera. Pavarësisht vonesave financiare, aktivitetet e planifikuara janë zhvilluar me sukses.
Si rezultat i punës së vazhdueshme të selektoreve dhe përkushtimit të sportisteve, gjimnastja Sara Pllana arriti të fitojë medaljen e bronztë në Kampionatin Ballkanik 2025, duke shënuar medaljen e parë në historinë e gjimnastikës kosovare të fituar në një kampionat zyrtar ndërkombëtar.

1.6 SHTRIRJA TERRITORIALE E PROJEKTEVE TË MBËSHTETURA

Federata e Gjimnastikës e Kosovës, e themeluar në vitin 2012 nga pesë klube, gjatë vitit 2025 përbëhet nga 15 klube të licencuara, të cilat veprojnë në territore të ndryshme të vendit.
Në Prishtinë funksionojnë pesë klube: Universiteti, Elita, Omnisport, Ardhmëria dhe Kulina. Klubet e tjera janë të shtrira në Fushë Kosovë, Vushtrri, Mitrovicë, Malishevë, Gjilan, Viti, Lipjan, Llapi, Skenderaj, si dhe Klubi i Gjimnastikës Ritmike Poise. Gjithashtu, Klubi i Gjimnastikës Ritmike “Ritmiks” nga Ferizaj është në proces pranimi në Kuvendin e Punës së FGJK-së.
Në përputhje me Ligjin për Sport dhe rregulloret e brendshme të Federatës, të gjitha klubet trajtohen në mënyrë të barabartë, pa dallim, dhe kanë të drejtë pjesëmarrjeje në të gjitha garat dhe aktivitetet e organizuara nga FGJK.
Duke marrë parasysh gjendjen e vështirë të infrastrukturës për gjimnastikë në vend, Federata gjatë vitit 2025 ka shqyrtuar dhe realizuar mbështetje konkrete për klubet me pajisje gjimnastikore bazë, në përputhje me kërkesat e paraqitura me shkrim. Në këtë kuadër, pas pranimit të një donacioni me vegla gjimnastikore, pajisjet janë shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe proporcionale tek klubet përfituese, me qëllim përmirësimin e kushteve të stërvitjes.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.7 PËRFITUESIT E DREJTPËRDREJT

Federata e Gjimnastikës e Kosovës gjatë vitit 2025 ka pasur të regjistruara 15 klube të licencuara, 2 klube të palicencuara dhe 1 klub në pritje për pranim në Kuvend, me dokumentacion të rregullt. Numri i përgjithshëm i gjimnastëve të licencuar është 286, prej të cilëve 262 janë femra dhe 24 meshkuj. Secili klub funksionon me së paku dy trajnerë, ndërsa në disa klube angazhohen tre, katër apo pesë trajnerë, varësisht nga numri i sportistëve dhe organizimi i brendshëm. Gjithashtu, gjatë vitit 2025 janë përfshirë në sistemin e gjykimit shumë gjyqtarë të rinj, të cilët tashmë kontribuojnë në garat e gjimnastikës artistike për femra dhe meshkuj.

1.8 INFORMACION LIDHUR ME REZULTATET E PROJEKTEVE

Sikurse në paragrafin 1.2 dhe 1.3 ku aktivitetet janë evidentuar me detaje, FGJK mbetet e përkushtuar në zbatimin e planeve të saj. FGJK ka prioritet këto projekte:

- *Promovimin dhe masivizimin e sportit të gjimnastikës, përmes rritjes së numrit të sportistëve dhe përfshirjes së klubeve të reja;*
- *Infrastruktura dhe rekuizitat (veglat) sportive të gjimnastikës,*
- *Përgatitje për pjesëmarrje në ngjarje sportive ndërkombëtare,*
- *Trajnimin dhe licencimin e trajnerëve, gjyqtarëve dhe stafin për menaxhim,*
- *Organizimin e rregullt të garave vendore në Republikën e Kosovës*
- *Zhvillimin e kuadrove të reja profesionale (gjetja dhe përfshirja e gjyqtarëve dhe trajnerëve të rinj);*
- *Forcimin e bashkëpunimit institucional me MKRS, KOK dhe federata ndërkombëtare;*

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

1.9 REKOMANDIMET PËRKITAZI ME MBËSHTETJEN FINANCIARE GJATË PERIUDHËS SË ARDHSHME

Federata e Gjimnastikës e Kosovës përfaqëson një sport sa të bukur, po aq edhe determinues në përcaktimin se sa ka përgatitje një shtet, dhe sa ofron kushte për zhvillimin e sporteve bazë siç janë Atletika, Gjimnastika dhe Noti. Duke qenë pjesë e këtij trekëndëshi sportesh që konsiderohen tri shtyllat kryesore, krahas përkrahjes që kemi gëzuar deri tani dhe të cilën e vlerësojmë, ne si federatë rekomandojmë që:

- Që salla e gjimnastikës në fshatin Miradi, të përfundohet në afat në mënyrë që FGJK të organizojë kampionatin Ballkanik, që është një test për FGJK-në para organizimit të Lojërave Mesdhetare.
- Proceduralisht të ketë më shumë fleksibilitet, dhe memorandumet të realizohen në afatet e parapara.
- Zbatimi i tyre të kryhet sipas planit, që do të thotë tremujori i parë apo TM1 të ekzekutohet me nënshkrimin e memorandumit apo më së voni 7 ditë pas, por jo më vonë se fundi i muajit Mars, dhe pastaj të tjerat sipas planit të tre mujorve.
- Po ashtu shumë me rëndësi për ne është që nëse afati për dorëzimin e Raportit Narrativ është 31 mars 2025 përgjigjja të jepet me shkrim nga DS apo MKRS federatave më së voni 7 ditë pas dorëzimit.

_____
Amir Tahiraga
Sekretar i Përgjithshëm i FGJK-së

_____
Arlind Shaqiri
Sekretari Teknik i FGJK-së

Prishtinë, 2026

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com